



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:011802

Datë: 26.03.2025

Numri i dokumentit: 07047543

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.211/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Valbonë Fejza me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonard Gashi në cilësi të procesmbajtësit, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.P. nga fshati P., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2558/19 të datës 27.01.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.02.2025 në prezencë të prokurorit së shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë Besart Mustafa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Afrim Salihu me seli të Zyrës në Prishtinë, të njejtën ditë në prezencë të akuzuarit dhe mbrojtësit mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H. P. nga babai O. dhe nëna F., mbiemri i vajzërisë së nënës M., i lindur me datë ... në P., Komuna e Prishtinës, ku edhe tani jeton, i identifikuar përmes letërnjoftimit me numër ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion vozitës i fëmijëve, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike-familjare, shqiptar-kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës,

## SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

- Me date ..., rreth orës 21:50, në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, saktësisht në fshatin B., Komuna e Prishtinës, i pandehuri H.P. nga pakujdesia në kundërshtim me nenin 151 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, derisa po drejtonte automjetin VË T-4, ngjyrë të kaltër, me targa ... në drejtimin Podujevë-Prishtinë, nuk ka frenuar dhe reaguar me kohë, kështu që me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit e ka goditur këmbësorin — të ndjerin A. K., i cili po kalonte rrugën jashtë vendkalimit për këmbësor nga ana e majtë- në të djathtë, me ç' rast i pandehuri shkakton aksident trafiku, ku lëndime të rënda trupore pëson këmbësori — i dëmtuari A.K., i cili ka ndërruar jetë në QKUK.

-Me këtë i pandehuri H.P. ka kryer veprë penale Rrezikim i Përgjithshëm i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 22, 23, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës e:

## GJYKON

Të akuzuarit H.P., i shqipton:

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve, nuk kryen veprë të re penale, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.05.2019 deri me datë 23.06.2019.

Obligohet i dënuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 40.88 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20

(njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Pala e dëmtuar F.K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 27.01.2020, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2558/19 kundër të akuzuarit H.P. nga fshati P., Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 27.02.2025 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Afrim Salihu, në të cilën seancë i akuzuari u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “: Si rrethanë rënduese le të merret për bazë dëmi i pariparueshëm kurse si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë, bashkëpunimi me organet e ndjekjes nga ana e të pandehurit, i cili në çdo fazë të procedurës penale e ka pranuar veprën penale”.

Mbrojtësi i të akuzuarit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit veç të tjerash ka deklaruar " Meqenëse i mbrojturi im e pranoj fajin në këtë stad të procedurës, gjykatës i propozojmë që ti ketë parasysh faktet e mëposhtme: Është hera e parë që i mbrojturi im ka kryer vepër penale, nuk është recidivist, meqenëse edhe vetë ekspertiza e cila është deponuar si provë në provat materiale

që janë në shkresat e lëndës, thekson se “ edhe vetë i pandehuri, ka mund të evitoj goditjen por nuk e ka bërë këtë, sa i përket, çështjes kur është shkaktuar aksidenti është përcaktuar edhe vetë në aktakuzë se këmbësori ka kaluar në pjesën ku nuk është e dedikuar vendkalimi për këmbësor, vetë familjarët tani të ndjerit, djali i tij F. K. në deklaratën e dhënë ne prokurori ka deklaruar se “ nuk i bashkëngjitet ndjekjes dhe nuk kërkon që H.P. të dënohet nga gjykata. Meqenëse i mbrojturi im e ka shkaktuar nga pakujdesia e pavetëdijshme këtë vepër, e cila është një ndër rrethanat e përgjegjësive subjektive si më të lehtë tek matja e dënimit, i propozoj gjykatës që në mënyrën më të sigurtë nga ana e jonë, të mos të ja jap dënim me burg, por të shkoj dënim me kusht ose në çoftëse eventualisht e dënon me burgim 6 muaj, ta zëvendëson me dënim me gjobë ”.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, i akuzuari deklaroi “Pajtohem me deklarin e mbrojtësit tim, shtoj se babai im pas ndodhjes së aksidentit, ka pas kontakte me familjarët e të ndjerit, ka shkuar ta vizitoj të ndjerin sa ka qenë gjallë në Spital, atë ditë kur i ndjeri ka ndërruar jetë, baba im ka pyetur familjarët e të ndjerit, për pjesëmarrje në varrim dhe të njëjtit e kanë lejuar dhe po atë ditë e kanë falur për rastin që ka ndodhur. Familjarët e të ndjerit nuk kanë pranuar që unë ti ndihmoj me të holla, për shkak se me arsyetimin e tyre, nuk kanë nevojë për të holla. Babai im ka shprehur vullnetin mirëpo të njëjtit s’kanë pasur nevojë”.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 22, 23, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK-së dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari H.P. ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të akuzuarin.

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë që të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e bashkëngjitura dhe deklarinimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti që të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata e analizoj ekspertizën e komunikacionit të ekspertit G.B. të datës 20.01.2020 në të cilën ka konstatuar se shpejtësia e lëvizjes së automjetit para përplasjes është 46.8 km/h dhe në momentin e goditjes së këmbësorit ka qenë 44.15 km/h. Bazuar në vendin dhe kohën e aksidentit

nuk ka pasur vendkalim të këmbësorëve, koha në të cilën ka ndodhur aksidenti ka qenë natë 21:50 dhe në bazë të dëshmive të ofruara këmbësori ka qenë me tesha ngjyrë të errët. Tutje në bazë të llogaritjes shkencore edhe pse ngasësi ishte duke lëvizur nën shpejtësinë e kufizuar prej 50 km/h, evitimi i aksidenti ka qenë i mundur mirëpo mungesa e koncentrimit të ngasësit gjatë drejtimit të automjetit nuk ka qenë në nivelin e duhur pra nuk ka qenë i vëmendshëm në rrjedhën e trafikut para tij, andaj si pasojë e kësaj pakujdesie ka ardhur deri te aksidenti i trafikut me lëndime të rënda trupore ku si pasojë e këtyre lëndimeve siç thuhet edhe në raportin e autopsisë vjen deri te vdekja e këmbësorit.

Duke vlerësuar veprimet e të pandehurit në ditën kritike, mund të konstatohet se në aspektin penal-juridik të njëjtat nuk kanë karakter të fortë të sjelljes kriminale, por janë shprehje e qartë e pakujdesisë së kryerësit, gjë që ka rezultuar edhe me cilësimin juridik të veprës penale për të cilën është shpallë fajtor i pandehuri.

Si rrethana lehtësuese gjykata gjeti pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën fillestare, keqardhja e shfaqur nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, faktin se babai i të pandehurit pas ndodhjes së aksidentit ka pasur kontakte me familjen e të ndjerit, ka shkuar ta vizitoj të ndjerin sa ka qenë gjallë në spital, familjarët e të ndjerit e kanë lejuar të marrë pjesë në varrim, ju kanë ofruar edhe ndihmë me të holla mirëpo të njëjtit nuk kanë pranuar me arsyetimin se nuk kanë nevojë për para. Ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Për të përcaktuar llojin dhe lartësinë e dënimit në rastin konkret gjykata vlerësoj peshën dhe ndikimin e secilës nga rrethanat e përmendura si me lartë.

Akceptimi i pranimit të fajësisë si rrethanë lehtësuese në këtë rast është i arsyeshëm, për shkak se i njëjti nuk bie në kundërshtim me rrethana të tjera rënduese të cilat do të mund ta zhvleftësonin vetë pranimin e fajësisë si shprehje e pendimit në aspektin material-jetësor dhe si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit në aspektin formal-ligjor, që në këtë rast aplikohet edhe si rrethanë për zbutjen e dënimit siç përcakton neni 71 par. 1 pika 3 të KPRK-së.

Gjithashtu rrethana tjetër se nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në kohën kur kjo çështje penale edhe u gjykua nga gjykata ka kaluar një periudhë relativisht e gjatë kohore, e si rrjedhojë në kontekst të parimeve dhe qëllimeve të dënimit gjykata vlerësoj se shqiptimi i ndonjë dënimi

me të rëndë nga ai i përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të ishte në kundërshtim me këto parime dhe qëllime.

Gjykata mori parasysh faktin se në rastin konkret vepra penale është kryer nga pakujdesia, faktin se i pandehuri nuk e ka dëshiruar shkaktimin e pasojës për viktimën, e gjithashtu faktin se veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale në parim nuk kanë qenë të drejtuara kundër jetës dhe trupit, gjë që tregohet edhe nga kategorizimi i kësaj vepre penale që hynë në kuadër të veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik.

Sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe shprehja e keqardhjes u morën si rrethana lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi që gjykata u bind se i pandehuri në mënyrë të sinqertë dhe me pendesë të thellë shprehu keqardhje për veprën penale dhe pasojat e shkaktuara, gjë që ka treguar edhe me iniciativën dhe gatishmërinë për të kontaktuar dhe për tu pajtuar me familjen e viktimës menjëherë pas kryerjes së veprës penale, faktin se babai i të pandehurit pas ndodhjes së aksidentit ka pasur kontakte me familjen e të ndjerit, ka shkuar ta vizitoj të ndjerin sa ka qenë gjallë në spital, familjarët e të ndjerit e kanë lejuar të marrë pjesë në varrim, ju kanë ofruar edhe ndihmë me të holla mirëpo të njëjtit nuk kanë pranuar me arsyetimin se nuk kanë nevojë për para.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe të gjitha së bashku, raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit H.P. është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69, 70 dhe 71 të KPRK-së.

Gjykata në dispozitiv të aktgjykimit vendosi që të pandehurit H.P ti shqiptoj dënim me burgim prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për shqiptimin e dënimit me kusht gjykata u bazua në nenin 46, 47, 48 par.2 dhe 49 par.2 dhe 3 të KPRK-së. Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit me kusht ndaj të pandehurit H.P do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja

e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim prej një (1) viti, është një paralajmërim shumë serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.2 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, e në këtë rast gjykata zbatoj dispozitën për zbutjen e dënimit nga neni 71 par.1 pika 2 dhe 3 të KPRK-së, përkatësisht u bazua në faktin se i pandehuri e pranoj fajësinë në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar dhe se në veprimet e kryerjes së të pandehurit u gjeten rrethana posaçërisht lehtësuese të trajtuara si më lartë.

Gjithashtu me rastin e vendosjes për shqiptimin e dënimit më kusht si alternative e burgimit, gjykata në mënyrë të veçantë vlerësoj se cili do të ishte efekti i ekzekutimit të dënimit më burgim për një të dënuar kur nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në kohën e gjykimit kanë kaluar pothuajse rreth shtatë vite dhe erdhi në përfundim se me ekzekutimin e dënimit me burgim do të rrezikohej njëri nga qëllimet kryesorë të dënimit që është “kthimi i kryerësit në shoqëri” si individ i rehabilituar dhe risocializuar. Ekzekutimi i dënimit në këtë rast do të mund të jepte efektin krejtësisht të kundërt të këtij qëllimi, pra do të kishte vetëm efekt retributiv ndaj të dënuarit H.P..

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga ana e të pandehurit llogaritet në dënimin e shqiptuar, konform nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor është marrë në kuptim nenit 450 par.1 dhe nenin 452 të KPRK-së, ndërsa vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kur u vendos që pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike të udhëzohet në kontest civil, gjykata është bazuar në nenin 462 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 365 dhe 370 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal

P.nr.211/20, me datë 20.03.2025

Bashkëpunëtor Profesional

Leonard Gashi

Gjyqtare e vetme gjykuese

Valbonë Fejza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.